



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.286/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Burim Ismaili, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, e paraqitur kundër Komisionereve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR (Pasafatshme) ankesa ZL.Anr.286/2025, të datës 21.10.2025, e parashtruar nga Burim Ismaili, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, e paraqitur kundër Komisionereve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 21.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesë ZL.Anr.286/2025, e parashtruar nga Burim Ismaili, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, në të cilën thekson se paraqet kërkesë për rinumërim të votave në qendrën e votimit 1502/1, 1502/2, 1502/3, 1502/4 në shkollën fillore Hasan Prishtina në Milloshevë, me arsyetimin se ka dallime të dukshme ndërmjet numërimit të votave të evidentuara nga vëzhguesit tanë në ditën e zgjedhjeve dhe rezultateve të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së. Tutje në ankesë parashtruesi thekson se sipas të dhënave të vëzhguesve tanë në teren: Klasa 1502/1 - 48 vota të evidentuara dhe 28 vota të publikuara, klasa 1502/2 – 84 vota të evidentuara, 75 vota të publikuara, klasa 1502/3 – 72 vota të evidentuara, 53 vota të publikuara, klasa 1502/04 – 60 të evidentuara, 15 vota të publikuara. Sipas parashtruesit të ankesës këto mospërputhje ngjallin dyshime të arsyeshme për gabime gjatë procesit të numërimit ose gjatë regjistrimit të rezultateve në sistem.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, thekson se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/1.228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit QKN, Procedurat e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 21.10.2025, ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Obiliqit, nga i cili ka marrë përgjigjen si më poshtë: *"Më lejoni të ju informoj se ne si Komision Komunal i Zgjedhjeve i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme të Qendrës Komunale të Numërimit në Obiliq sipas ligjit dhe rregullores së QKN-së. Numërimi i Votave është bërë nga 4 Numërues të cilët janë nga Subjektet Politike L VV, LDI, PDK dhe AAK ku gjithçka është nën vëzhgimin e kamerave të sigurisë si dhe është përcjellë edhe nga Vëzhguesit e subjekteve politike. Sa i përket kësaj ne si Komision Komunal i Zgjedhjeve nuk kemi marr asnjë ankesë gjatë procesit të numërimit nga ana e vëzhguesve. Numërimi në Qendrën Komunale të Numërimit në Obiliq ka filluar më 14.10.2025 dhe ka mbaruar më 16.10.2025 në ora 11:00, gjithçka ka qenë në bazë të procedurave të numërimit, ". Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Obiliqit, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 16.10.2025, në ora 11, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 21.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit "105.1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e palejuar-(pasafatshme).

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Burim Ismaili, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Obiliqit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, e paraqitur kundër Komisionereve të Vendvotimit dhe QKN, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Obiliq, është pas afatit ligjor të përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se”. *Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*“, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, *parashihet që “Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”, ndërsa nën paragrafi 5.16 parasheh që “Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR”.*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 21.10.2025, ku ka pretenduar se ka dallime të dukshme ndërmjet numërimit të votave të evidentuara nga vëzhguesit e tyre në ditën e zgjedhjeve dhe rezultateve të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së, në vendvotimet 1502/1, 1502/2, 1502/3, 1502/4 në shkollën fillore Hasan Prishtina në Milloshevë, **ndërsa aktiviteti i QKN-së, në Komunën e Obiliqit, është përmbyllur me datën 16.10.2025, në ora 11,** me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit "105.1. *Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*

Andaj, nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.286/2025 më datën 22.10.2025

Kryesues i panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.